

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, mazhoranca dhe opozita në një zë: Vendim i padrejtë, një aktgjyqi m nuk mund të rishkruajë historinë e një populli
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/81-vite-burg-per-ish-kreret-e-uk-se-mazhoranca-dhe-o-pozita-ne-nje-ze-ve-i586696
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:23:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 13:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a48d74ce7ed5be90cd4cee006e1d44b74ed4503f369e39b9d152de893c44454e
TEKSTI	229f560153c3020cdca2a66c66a5ada27850cc6c7aebf8dd5c369a63647fb44d
PAMJA	6bb3aedb8beed3196b23d52f94dea92c8df20c69aafe0fdb56be96f86007827

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f706b5022d363a02a7815711065bdca49c0c961e65fb047b756115731c6fd281
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b99bb89ad091208af3c2b8534814a2155c6e198d9adcb338cc8f4ec8b0016659
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f706b5022d363a02a7815711065bdca49c0c961e65fb047b756115731c6fd281>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



Ne emer te popullit te Kosoves Alarm i rreme per bombe ne shkollen "Emin Duraku." "detyrim paraqitje" per Mandi Jataganin: Do ta bej serish nese... Andrej Kurkov vjen fundit

81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së, mazhoranca dhe opozita në një zë: Vendim i padrejtë, një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli



17 Shtator 2026, 15:30Politika TEMA



PS dhe PD ulën përkohësisht armët. Dënimet me 81 vite burg i katër liderëve të UÇK-së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit i ka bashkuar ata në zhgënjimin ndaj gjykatës së Hagës.

"Vendim që e konsideron të padrejtë ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. Kuvendi rithekson një të vërtetë historike: Lufta e UÇK-së ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, ishte lufta e një populli për t'i dhënë fund represionit, dhunës dhe përndjekjes.

Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit sistematik, spastrimit etnik dhe gjenocidit të kryer nga Millosheviçi. UÇK-ja ishte forcë vendimtare e rezistencës së popullit të Kosovës. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë të pandashëm nga kjo histori, nga rrugëtimi i Kosovës drejt lirisë.

Një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli, nuk mund të zhbëjë sakrificën e UÇK-së.

Kuvendi shpreh shqetësimin për standardet e dyfishta. Nderimet publike që u rezervohen personave të dënuar për krime lufte dhe glorifikimi i Mladiçit cenon pengesën e viktimitave, pengojnë pajtimin dhe bien ndesh me vlerat evropiane", tha Peleshi.

Kjo deklaratë u parapri nga akuzat e opozitës se shteti shqiptar nuk ka bërë sa duhet për Kosovën.

"Rama i futi thikën pas shpine Kosovës, shkoi dhe diktoi votimin e një ligji që nuk votohej kurrë. Shkoi i deleguar i Aleksandër Vuçiç. Shkoi kreu porositë e Vuçiç, e dëgjove o kryetar të thotë një fjalë të vetme. Çfarë tha ai për këtë që ndodhi në Hagë. Ku e keni ministrin", tha Berisha.

"Lot krokodili për dënimin e liderëve të UÇK-së. Elita këtu, Edi Rama në veçanti ka dashur dënimin e tyre. Çfarë ka bërë shteti shqiptar? Keni hedhur para për lobim? Zero", tha Erald Kapri.

"Nuk është gjithçka marrëveshje biznesi", iu përgjigj Peleshi.

Opozita thotë se nuk mjafton vetëm deklarata e përbashkët. Për të detyra e Kuvendit është të dënojë zyrtarisht përmes një rezolute gjenocidin serb mbi Kosovën, në përmbajtje të së cilës duhet të jetë kërkesa ndaj shtetit të Serbisë të njohë Kosovën. Kërkesë, e cila ende nuk është pranuar nga mazhoranca.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[VIDEO/ Ministria Shëndetësisë, Spahiu në Kuvend: Në 2027-ën ose do sjell PET Scan-in, ose do jap dorëheqjen](#)

14:00 Politika / 3 komente

[FOTO/ Protestuesit përmbysin kazanët e mbeturinave para selisë së PD](#)

12:35 Politika / 10 komente

Kumbaro në Kuvend: Shqipëria përmirësoi rezultatet në PISA, përzgjedhja e shkollave u bë sipas metodologjisë së OECD-së

12:12 Politika / 5 komente

[VIDEO/ Tensione në protestë, qytetarët sulmojnë me vezë e shishe uji policët! Ka të shoqëruar](#)

11:57 Politika / 28 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.